


VITI XVI, NUMRI 9 / SHTATOR 2012


FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA

**BACK
TO
SCHOOL**





ME BESIM



TEK SUKSESI

Nuk mund tua tregoj se sa i lumtur u ndjeva kur takova kaq shumë nga ju në Super Rally, këtu në Phoenix. Me ndershmëri jua them se megjithse jam kënaqur shumë me dy Super Rally-et në Denever dhe Washington DC, në këtë të tanishmin përjetova një ndjenjë të veçantë dhe zemra mu emocionua shumë, duke patur mundësi të kaloj kohën me kaq shumë nga ju, këtu në truallin e vetë të Foreverit. Shpresoj tu ketë pëlqyer edhe juve ky turne në zyrat e Forever Living dhe në qendrën e prodhimit të produkteve Forever Nutraceutical. Ju përgëzoj të gjithë juve që punuat fort e me përkushtim për tu kualifikuar për Super Rally , si dhe për turnetë e Silver dhe Traditional Post Rally. Dhe u faleminderit që këtë Rally e kthyet në një eveniment madhështor.

Ndërsa ju po kënaqeshit plotësisht me Super Rally-n në Phoenix, unë po mendoja se çfarë mundësish të mëdha sjell Global Rally ynë i ri. Mund të pyesni veten.”Po a mund ta realizoj unë? A mund të arrij edhe unë vitin tim më të mirë në Forever? A mund të shkoj edhe unë në Hawaii? Ju keni akoma periudhën deri më 31 Dhjetor për tu kualifikuar për këtë udhëtim të veçantë të jetës së tuaj. Dhe e vetmja gjë më e rëndësishme që ju duhet për ta arritur këtë objektiv është besimi.

Kur flas për besimin gjithmonë citoj Eleonor Roosevelt”Çdo të mund të realizonim sikur ta dinim që nuk do të dështonim?” Mendoni për një çast se çfarë ju duhet për tu kualifikuar për Global Rally. Duhet vetëm 1500 pikë për të mbërritur atje. Foreveri ju ofron çdo mundësi për të arritur të gjithë objektivat tuaja: të siguron pavarësi financiare, të përmirësoni shëndetin, të sigurosh mardhënie të vecanta dhe tua përcjellësh këto edhe të tjerëve. Ajo që ju duhet është besimi se me Foreverin si mbështetje, nuk ka kurrfarë mundësie për dështim.

Për të siguruar që ky të jetë viti më i mirë i juaj në Forever ka disa mënyra. Së pari mos harroni se sa njerëz e kanë realizuar para jush këtë sukses të dukshëm. Pikërisht në gazetën mujore ne shpalosim rrugën që kanë bërë këta individë për për të arritur këto nivele të rëndësishme realizimi dhe kremtojmë suksesin e tyre. Kur e kanë realizuar këta distributorë, mund ta realizoni edhe ju. Ajo që ju duhet është të mendoni për suksesin e atyre që kanë kaluar para jush, dhe të keni besimin se edhe ju mund ta arrini këtë sukses.

Së dyti, të vlerësoni sukseset që keni arritur deri tani. Qëndroni një moment dhe shikoni rezultatin që arritët vitin e shkuar. Çfarë bëtë mirë? Ka shumë rëndësi të përqëndroheni në aspektet pozitive të performancës tuaj, duke e rikrijuar sukseset tuaj ndërkohë që punoni për realizimin e objektivave tuaja. Mos qëndroni me dëshpërim tek dështimet. Dhe po ke bërë ndonjë gabim, mba një shënim të vogël dhe thuaj vetes „Herën tjetër do ta bëj më mirë” Dhe pastaj mendo se çfarë duhet bërë për të realizuar objektivat deri në fund të vitit.

Me besimin e duhur, ju mund të plotësoni angazhimet tuaja ndaj Foreverit, me vetëdijen se ju e dini saktësisht se çfarë duhet bërë dhe ju mund ta bëni atë, dhe sapo ta keni realizuar, shpërblimi ia vlen mundimin. Nuk ka fusha të jetës, që ju ofrojnë mundësi të tilla të garantuara për të fituar të gjithë stimujt që Foreveri ka krijuar për ju. Edhe një herë ju përgëzoj për sukseset e mëparshme, dhe ju inkurajoj të keni besimin e duhur për ta bërë këtë vitin tuaj më të mirë në Forever.



Rex Maughan

I JUAJI
REX MAUGHAN



Holiday Rally



Erdhi shtatori, gjithkush përgatitet me forca të përtërira për Global Rally-n e 2013-ës. Edhe ne sapo u kthëm nga SHBA dhe të gjithë synojmë që në të ardhmen të jemi atje në ishujt prrallor të Hawaiiit, në takimin e përmasave botërore të Foreverit. Mënyrë të menduari globale, ide të përmasave botërore, liri financiare, objektiva individuale, por qëllime të njëjta na rrethojnë dhe na udhëheqin çdo ditë. Duke medituar për këto, vijmë në konkluzionin se edhe ne në rajonin tonë duhet të mendojmë pak ndryshe: duhet të caktojmë objektiva të mëdha dhe duhet ta vendosim më lartë njësinë matëse.

Në 2013 edhe vëndi i Holiday Rally do të ndryshojë, ai do të jetë në një nga perlat e perandorisë së dikurshme austro-hungareze, në Opati (Abbázia) ku dikur ishte vëndi preferuar i takimit, argëtimit e pushimit të ish perandorëve, mbretërve, guvernatorëve, princërve. Brënda kësaj ndodhet edhe Hotel Ambasador, një nga më të bukurit në bregdetin e Adriatikut. Në Sallën e Kristaleve me famë botërore do të dëgjojmë leksionet e bashkpunëtorëve tanë të shkëlqyer, Diamant Menaxherët, si Miklós Berkics, çifti Lomjanski, familja Gidófalvi.

Në qoftë se biznesin e ke filluar tani, të ofrohen mundësi të tilla, të cilat rrallë i jepen njeriut në jetë. Cila është detyra ime?, mund të pyesësh veten: tu ofroj të njohurve, miqve, pjestarve të familjes, produkte të nivelit botëror të një firme të klasit botëror, që ata dhe natyrisht edhe unë të mund të jetojmë një të ardhme më të sigurtë materiale. Kjo në fakt është një ofertë e pabesueshme, dhe krahas kësaj si dhuratë për ty edhe një udhëtim lluksi. Bashkë punojmë, bashkë qeshim, festojmë dhe pushojmë – e gjithë kjo si mirësi e drejtorit tonë të përgjithshëm Rex Maughan.

Shumë herë kam menduar se si mund ta falnderojmë Rex-in si mund ti shprehim mirënjohjen tonë në mënyrën më të mirë, për mundësitë e shumta që na ka dhënë. Përgjigja është shumë e thjeshtë: të pranojmë ofertën, të plotësojmë kushtet dhe do ta ndjejmë veten mirë në Holiday Rally. Do të mësojmë shumë nga më të mirët dhe do të fitojmë një vull të ri për vitin e ardhshëm. Ata që e kanë „provuar një herë thelën e Holiday Rally”, për ata ky takim është bërë ide fikse. Këtu brënda disa ditëve mund të mësosh në mënyrë koncentruar ato gjëra që do të jenë dashur ti përvetsosh për disa muaj, nga librat dhe nga materialet video e CD. Në Holiday Rally mund të mësosh nga më të mirët e botës!

Nga 1 Shtatori nis programi stimulues Holiday Rally III, që tashmë jep mundësinë e kualifikimit për takimin e 2013 në Opatija. Kushtet nuk kanë ndryshuar, vlerësimi është në nivelin më të lartë të mundshëm.

Në qoftë se nuk kupton diçka nga kjo shpallje, mos kërkoi andej këndeje, por pyet menjëherë sponsorin tënd. Ai është njeriu që të kap për dore deri sa të arrish nivelin e supervizorit apo të menaxherit. Pastaj ti do të kapësh të tjerët për dore dhe do ti mësosh ata. Në qoftë se dëshiron një jetë të bukur dhe me përmbajtje, me qetësi dhe siguri materiale, atëherë nisni për në Holiday Rally dhe takohemi në 2013 në Opatija! Natyrisht në Tetor kemi direkt para nesh edhe një takim mbyllës Holiday, në Porecs. Këto trainime janë vendimtare në jetën tonë. Në qoftë se dëshiron të bësh diçka për veten dhe familjen tënde, atëherë vëndi yt është atje!

DR. SÁNDOR MILESZ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM





BUDAI TAMÁS (1968-2012)

Na ishte një herë...

Na ishte një herë një djalosh, që dashuronte, mësonte, luante sport, bënte karate, ndeshej, qeshte dhe gajasej. Bënte një jetë siç ia donte zemra. Ndeshej me kulçedrën me 7 koka, përshkonte dunat me rërë, zbulonte detet dhe sundonte shkretëtirat. „Jam përgatitur me dy lloj leksionesh, një me dashamirësi dhe një me sinqeritet. Cilin do të donit të dëgjonit?” Këtë shprehje e njejtë gjithkush në rajonin hungarez të Foreverit.

TAMÁS BUDAI. Emri me gërma të mëdha. Emri që simbolizon mikun dhe djaloshin e sinqertë, babain krenar, vëllain e gatshëm për ndihmë, bashkshortin e dashur, drejtuesin e përkushtuar, lektorin e çiltër, Luftëtarin e paepur.

E kam njohur para 18 vjetësh në një nga hotelet e Pragës, duke shijuar djathin dhe duke dëgjuar një lloj muzike me kitare. Kishim vite që nuk ishim takuar. Pastaj duke u kthyer nga Japonia, „ndeshi” në kuti Touch, „si rastësisht shkova në Gyöngyös... Por nuk ishte një nisje e lehtë. „Ti Zsolt, nuk do të mund të kishe diçka më elegante, veturë, ar... po edhe lëng kaktusi?! Çdo të mendojnë për mua? Çfarë?! Qëndronte atje anë të pistës, duke parë çfarë po ndodhte. Hidhte themelet e një perandorie, duke tërhequr në të drejtuesit e mëvonshëm.

Për shumë kohë punuam bashkë. Kur filloi si i pavarur, eci përpara shpejt dhe me vendosmëri. Edhe në Forever e karakterizonte vetëdija e detyrës që e shoqëroi deri në fund në garat në fushën e sportit. I pëlqente stimujt, sfidat për jetën e atyre që kishte në ngarkim. Dinte të luftonte dhe mësoi të luftonte.

Me gatishmërinë e plotë që e ndjente nga brenda niste, ndihmonte dhe motivonte bashkpunëtorët. Tregoi se nga i huaj mund të bëhej mik, drejtuesit i trajtonte me kujdesin atëror. Kushdo mund ti drejtohej me besim. Ishte model, udhërrëfyes. Ishte njeriu, të cilin mund ta falnderojnë shumë, se jeta e tyre u bë më e mirë. Gjithmonë mund ta llogaritje si mbështetje. U bë një nga drejtuesit e vendosur të Foreverit, u bë IKONË. Nuk mund të mos e vije re. Me humor, me kërcim të sigurtë dhe me vulltin e tij sundonte skenën.

Tomi, ky ishte Tomi. Si bashkë-themelues u bëmë mamitë e lindjes të Eagle Team, dhe me kënaqsi vrenim rritjen e saj. Në mënyrë aktive bashkpunoi edhe me drejtues të tjerë të linjës së sipërme si me Teca Hermann,



Zsolt Leveleki. Tomi! Ëndërra jonë e përbashkët u realizua! Si trashëgimi na le rrë një të krahët e fëmijve të tu, „të biznesit,„ Do ti ndihmojmë ata të fluturojnë më tej!

Biznesi dhe familja tek ti ishin plotësisht të gërshetuara. Me dashuri të veçantë i rrite fëmijët e tu, jetove si motorr i familjes, jetën e tyre e ndërtove si model.

„Mami ku po shkoni?” – na pyet vajza jonë e vogël.
„Ti japim lamtumirën një mikut tonë.”
„Do shkojë larg?”
„Po, shumë larg.”
„Do të qëndrojnë gjatë?”
„Shumë gjatë...”- pëshpëriti ime shoqe.
„Atëhere çojini atij çokollatat e mija që të mos ketë uri...”

Kur është fëmi njeriu endërron për heronj. Lexon libra, shikon filma, i krahason me ata që luajnë rolet. Tomi këtë e realizoi. U bë hero, heroi ynë. Me ne ka mbetur shpirti i tij, në vesh na jehon e qeshura e tij... ta ruajmë. Këtu kam çokollatat dhe mjaftë mbresa e mendime të pa shkruara...

Do ta mbajmë gjallë atë që filllove! Udhëtim në paqe! Të duam Tomi!

Miq të e tu,
Zsolt Fekete dhe Noémi Ruskó

“Tamás, Vizita e paparishikuar dhe e papritur e vdekjes të rrëmbeu para kohe nga ne. Çdo rrahje e zemrës tonë dhe lutjet tona u drejtohen të dashurve të tu, miqve dhe atyre që të njihnin. Lutemi që të lehtësohet dhimbja e tyre. Zhvillove beteja të forta, dhe shëmbulli që le pas do të ndihmojë ata që në këtë luftë kanë qëndruar përkrah teje.”

Aidan O’Hare



FOREVER 

SUPER RALLY

PHOENIX 2012

16-18 GUSHT 2012.

Këtë vit familja e madhe Forever u takua në truallin e vet Foreverit në Phoenix. Si çdo vit tjetër edhe sivjet në takimin tradicional erdhën distributorët më të sukseshëm, ku bashkpunëtorët e ardhur nga shumë vende të botës i pritën personalisht drejtuesit e firmës. Pjestarët e grupit të Hungarisë dhe të vendeve të rajonit na kanë shkruar se si i përjetuan ditët përtej detit.





„Më erdhi keq për ko incidencën, që pikërisht në kohën e Super Rally-t, më lindi mbesa, dhe kështu u detyrova të marr pjesë i vetëm, por jam shumë krenar për rezultatet fantastike. E ndjeva veten shumë mirë!”

**Attila Gidófalvi, distributori numer një në botë,
Diamant menaxher, 12500 cc**



„Me FLP çdo Rally është më i miri, mbasi marrin pjesë menaxherët më të mirë, më të mirët sulmuesit, dhe midis më të mirëve nuk ka kufizim!Eja dhe ti në Global Rally! Urra!”

**Veronika Lomjanski dhe Stevan Lomjanski – Diamant
menaxherë, anëtar të Klubit të Presidentit, 2500 cc**



„Është një ndjenjë e mrekullueshme, të jesh bashkë me ata njerëz, virtut i të cilëve është respekti, zelli, nderimi dhe qëndresa. I dashur Rex, përlësisht faleminderit për mësimet e shumta. Shumë „koka të mëdha” do të mund të mësonin prej teje! Rally i fundit?! Një diçka e madhe ka filluar, Prilli i 2013, Hawaii, Global Rally! Ka vend edhe për ty! Unë thërras, Aloha!”

József Szabó, Zafir menaxher 5000 cc





„Kohët e fundit me dhimbjet janë përzier dashuria, mirnjohja dhe ndjenja e përgjegjësive. Dashuria që rrezaton mbi ne FLP, Rex Maughan dhe „familja“. Mirnjohje, që mund të jemi pjesë e kësaj familje dhe mund të shijojmë sigurinë dhe lirinë dhe përgjegjësinë e dhënë nga ky biznes, që këtë Bekim ta ndajmë me sa më shumë njerëz, ashtu si dhe mrekullinë e produkteve të reja e të vjetëra dhe sigurinë e dhënë nga biznesi.”

Tünde Hajcsik dhe András Láng - Senior Eagle Menaxherë



„Do të doja të falnderoja drejtuesit e FLP Hungari, Dr. Sándor Milesz, Péter Lenkey, dhe Zsuzsanna Petróczy, për kujdesin e treguar për gjithçka dhe për atë që e ndjemë veten shumë mirë në Super Rally-n e 2012. Për ne ishte një gjë e veçantë që mundëm të merrnim direkt nga Rex Maughan kualifikimin Zafir menaxher, me një pllakë mermeri në gravurë me emrat e 9 menaxherëve tanë.”

István Kása & Istvánné Kása - Zafir Menaxherë, anëtarë të Klubit të Presidentit



„Këto udhëtime japin mundësinë të shikojmë botën, të mund të shikojmë bukuritë e natyrës, të gëzohemi e argëtohemi së bashku me kolegët dhe bashkpunëtorët në lirinë e merituar. Në takimet Rally mund të ndiejmë përsëri, që përfaqsojmë një gjë të mirë. Me orë të tëra valëvitëm flamurin hungarez, dhe të gjithë u ngazëllyem për rezultatet e arritura.”

Dr Ilona Juronics Vargáné - Soaring Menaxhere, Anëtare e Klubit të Presidentit, 1500 cc



„Kur diçka është rasti i fundit, gjithmonë është trishtuese. Por kjo nuk ishte karakteristike në këtë Rally, përkundrazi! FLP funksionon prej 35 vjetësh, prej 20 vjetësh organizon takimet Super Rally, prej 10 vjetësh Silver Post Rally, ku kemi shkuar në vendet e mrekullueshme, por tani vjen Global rally, ku bota zgjerohet më shumë, dhe mund të shkohet edhe në vendet ë tilla ku deri tani ka shkuar me World Rally vetëm një rreth më i ngushtë. Deri në fund takimi u karakterizua nga shpresa dhe atmosfera e gëzuar. Për një kohë i thamë mirupafshim zyrave qëndrore të Foreverit dhe mezi presim Hawaiiin. Urra!”

Dr. Terézia Samu - Soaring Menaxhere, 1500 cc





„Krahas atmosferës së ndezur, për ne një nga përshtypjet më të mëdha ishte darka ku në fund mundëm të çlirohemi nga frika dhe të mund të caktojmë objektiva të reja për të ardhmen. Dhurata është një ide gjeniale, forcon ndjenjë e luajalitet tek firma. Faleminderit! Përshtypja tjetër e shkëlqyer ishte vizita në Zyrat Qëndrore të FLP dhe në fabrikën e prodhimit Forever Nutraceutical. Takuam Rex Maughan dhe Steve Hatchettel, ku pamë sigurinë në funksionimin e FLP dhe të furnizimit me produktet.”

Dr Edit Révész Siklósné & Zoltán Siklós
Soaring Menaxherë



„Bota e ndjenjave të marra në Super Rally është e papërshkueshme. Për mua ishte një përshtypje e përjetshme dhe një mrekulli e përhershme. Faktet flasin vetë: 1. Produkte të reja të shkëlqyera. Motivi kryesor i mësimit të biznesit të marrë në Rally: Duhet të bëhesh menaxher Eagle, dhe me menaxherë Eagle të ndërtosh biznesin për Diamant. Faleminderit që munda të përjetoj takimin botëror të 2012!”

Melinda Gulyás - Senior Menaxhere



„Prej muajsh e prisnim me emocione gushtin. U përgatitëm për udhëtimin e madh. Ta përjetonim bashkë me sponsorat tanë Super rally-n e fundit , në qëndrën e firmës, prej kohësh kjo figuronte në objektivat tona. organizimi i takimit ishte profesional, me gjithë madhështinë e firmës, e shumë të edhe madhështia njerëzore. U kthyen në atdhe plot me përshtypje të veçanta. Faleminderit Rex. Faleminderit sponsorve tanë!”


Adrienn Háhn & Dr. Attila Nagy - Menaxherë





„Përshtypjet që patëm janë të papërshkrueshme. Ato nuk mund ti shprehësh me fjalë, këtë e ndjen gjithkush. Na u përforcua besimi në vetvete, që do të jetë përcaktuese në punën tonë të mëtejshme. I faleminderit kujdesit të mentorëve tanë, Dr. Terézia Samu dhe András Bruckner si dhe u jemi mirnjohës sponsorve tanë për mundësinë që na dhanë. Rally ishte fantastik, u mbushëm me shpresa dhe forcë. bashkpunëtorëve tanë u japim si mesazh, kush dëshiron, është në gjendje ta realizojë!”

Tamás Tóth dhe Emilia Bostyai - Menaxherë



„Ky ishte Super Rally i tetë që kam marrë pjesë, ky ma shtoi pak nostalgjinë sepse ishte i fundit. Pavarësisht nga kjo skuadra e Phoenixit e mbylli në fushën e vet me një organizim të përsosur kapitullin e „Super-ve” Dhe tani Go Global Rally! Go Hawaii!”

Dr. László Molnár - Senior Menaxher, 1500 cc

„ Pika kulminante e Silver Post Rally-t ishin leksionet e shumta të shkëlqyera, ku fjala e Gregg maughan më preku më shumë. Vecanrisht ajo pjesë për shkuarjen e fëmijës në shkollë dhe historia e detyrimit familjar që tregoi lidhjet dhe dashurinë e vërtetë njerëzore. Vitet fluturojnë shpesh, prandaj duhet të kemi në çdo moment një bashkjetesë cilësore që me Foreverin tu japim gëzim familjeve tona.”

Aranka Vágási - Diamant-Zafir menaxhere, anëtare e Klubit të Presidentit , 2500 cc



„Udhëtimi tre javor përbëhet nga disa momente të paharrueshme. Punën e fortë të investuar gjatë gjithë vitit, firma ta shpërblen në disa forma. Dhe ka një lajm të gëzuar, kur sheh zhvillimin e kësaj kompanie, me produkte të reja cilësore dhe me atë përkrahje të pabesueshme, ku të ofron mundësi të pafund në këtë biznes. Prandaj ju lutem, i vini objektivet vetes dhe ejani të udhëtojmë së bashku në Hawaii, sepse do të jetë interesante të merrni pjesë. Por duhet ditur edhe ajo që FLP është një organizatore e shkëlqyer, të vetmuar kurrë nuk do të kishim mundur të kishim këto përshtypje. Dhe kjo nuk është histori parash, por flet për forcën e përvojës së përbashkët. Faleminderit të gjithë pjestarëve të firmës dhe vazhdoftë për shumë vite kjo veprimtari e bekuar!”

Tomislav dhe Andreja Brumec - Zafir Menaxherë, anëtarë të Klubit të Presidentit, 2500cc





„Pas çdo Rally kthehemi në atdhe të mbushur me shpresa dhe të sigurtë se: JEMI NË FIRMËN MË TË MIRË! Organizimi nga ana e firmës, eleganca e hotelit, mrekullia e mjedisit, dhe profesionalizmi i programit Rally na magjepsën. Durimi i Rex-it për të bërë fotografi me të gjithë, shfaqja e lirshme e Greggut, që na largoi ndrojtjen, vrulli gazmor, i gjallë dhe motivues i Aidan i bënë të paharrueshme çdo minutë të këtij Super Rally. Lutemi për produktet e reja dhe mezi presim ti ofrojmë edhe tek ne. Epoka 20 vjecare e Super Rally kaloi duke ia zënë vëndin Global Rally i ri, një periudhë e re në jetën e Foreverit por edhe në jetën tonë. Faleminderit për 10 Super Rally-t dhe mirë u takofshim në Hawaii!”

Éva Keszi Szépné dhe Mihály Szép - Soaring menaxherë, 1500 cc



“Së pari urime Kati dhe Attila Gidófalvi që u bënë distributorët më të mirë në botë. Nga tani ata do ti thërrasim No. 1! Një gjë e veçantë ishte ajo e mirsëardhjes të Rex-it në darkën e kaluar me ne, se në fillimin e fillimit edhe ai ka patur frikë, por duke lënë pas frikën, besimi e çoi përpara. Ky Rally ishte një rast i shkëlqyer, që të flakim frikën, të pimë më shumë Aloe dhe të jemi pjesë e FOREVOLUTION!”

Csaba Pintér - Senior Menaxher, 1500 cc

PROGRAMI

FOREVER

SUPER RALLY

PHOENIX 2012

PROGRAM

16 GUSHT

Paradite: Business Training: Bëhu dhe Ti Menaxher Eagle!
Mbasdite: Prezantim i produkteve të reja Arctic-Sea – prezantuar nga Dr. Jorn Dyer, profesor i çmimit Nobel

Vitolize for Women – prezantuar nga Sherry Torkos, farmacist
Vitolize for Men
Sonya Luscious Lips,
Sonya Mini Palettes
Mbrëmje: Darka e kualifikimeve

17 GUSHT

Paradite: Dita e I-rë e Super Rally
Mbasdite: Shetitje në – Home Office & Forever Nutraceutical

18 GUSHT

Dita e II-të e Super Rally

**HAWAII
GLOBAL RALLY
2013
21-29 APRIL**

We'll see you in paradise...
ALOE-HA!





NIVELIN E SENIOR MENAXHERIT E ARRITI



Andrea Nagy
(sponsor: Filipov-Ágnes Vass)

“Po ke objektiv të forte, do të gjendet dhe zgjidhja!
Rezisto, ti je çelësi i suksesit tënd!”



NIVELIN E MENAXHERIT E ARRITËN



László Bartus & Maria Czalbert Bartusné
(sponsor: Andrea Nagy)

“Vetëm FOREVERI mund të të japë force dhe
vullnetin për të arrirë gjithshka”



Ana Cvijanović & Božidar Cvijanović
(sponsor: Smiljanic Petra)

„Suksesi dhe lumturia na dalin përpara, kur jemi të
hapur, besojmë në unin tonë më të mire, harrojmë
të kaluarën dhe marrim përgjegjësitë.”



Ferenc Kelényi
(sponsor: Andrea Nagy)

„Tashmë para disa vitesh isha njohur me produktet
e Foreverit, por duke pare dhe duke provuar
koleksionin e sotëm të fuqishëm, për mua u bë e
qartë sat ë efektshme janë. vetëm të mund tua



NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Baráth György
Halmi Bence István
Matija Jagodin & Sandra Jagodin
Jónás Éva
Majda Koglot & Lučjan Koglot
Kreicsik Ilona



NIVELIN E SUPERVISOR-IT E ARRITËN

Alekszejenkó Viktorné Dr. Simon Zsuzsanna
Alevané Utasi Zsanett & Aleva Ferenc
Vehbi Alimuca
Bedó Gábor & Bedó Mária
Cseke András László & Daróczy Orsolya
Denkné Czuczai Zsuzsanna
& Denk Zoltán
Dr. Kozó Lászlóné
Géczy Viktor
Hámori Gergő
Hasenfratz Rozália
Kirsner Erika
Komor Bettina
Kömives Benjamin
Lovró Bernadett
Mladen Pandurević
& Tatjana Pandurević
Masa Paravan
Franc Pirc
Mirijam Pirc & Marko Pirc
Pletser Krisztina
Pletser Györgyné & Pletser György
Presenszki Petra
Katica Prpić
Tatjana Tomović
Tóth Viktória
Jadranka Veličković
& Bratislav Veličković
Sonja Vranešić & Darko Vranešić
Veselinka Vukić

60GG+

TË KUALIFIKUARIT 07. 2012.

Nagy Andrea
Kelényi Ferenc
Erika Davis & Henry Davis
Éliás Tibor
Vágási Aranka & Kovács András
Jadranka Kraljić-Pavletić & Nenad Pavletić
Halmi István & Halminé Mikola Rita
Dr. Keresztényi Albert
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Senk Hajnalka
Predrag Židaković & Svetlana Židaković

Meggyesi Imre & Meggyesiné Kántor Tamara
Varga Géza & Vargané Dr. Juronics Ilona
Dr. Fábíán Mária
Ana Cvijanović & Božidar Cvijanović
Mázás József
Tóth János
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin & Dr. Seres Endre
Varga Józsefné
Csuka György & Dr. Bagoly Ibolya
Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
Tóth Tamás & Bostyai Emília



BASHKË NË RRUGËN E SUKSESIT



FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1

Jožica Arbeiter & Dr. Miran Arbeiter
Becz Zoltán & Kenesei Zsuzsanna Viktória
Bruckner András & Dr. Samu Terézia
Marija Buruš & Boško Buruš
Dr. Dósa Nikolett
Éliás Tibor
Olivia Gajdo
Gecse Andrea
Gombás Csilla Anita & Gombás Attila
Gyurik Erzsébet & Sándor József
Hajcsik Tünde & Láng András
Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
Hertelendy Klára
Illyés Ilona
Rinalda Iskra & Lučano Iskra
Dragana Janović & Miloš Janović
Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
Sonja Jurović & Zlatko Jurović
Kis-Jakab Árpád & Kis-Jakabné Tóth Ibolya
Dr. Keresztényi Albert
Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida
Klaj Ágnes
Jadranka Kraljić-Pavletić & Nenad Pavletić
Kúthi Szilárd

Lapicz Tibor & Lapiczné Lenkó Orsolya
Lipp Szilvia & Molnár Mihály
Dr. Molnár László
& Dr. Molnár-Stantić Branka
Muladi Annamária
Nagy Ádám & Nagyné Belényi Brigitta
Vaselije Njegovanović
Dr. Pavkovic Mária
Dr. Marija Ratković
Dr. Rokonay Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
Sebők Judit
Senk Hajnalka
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin
& Dr. Seres Endre
Tihomir Stilin & Maja Stilin
Sulyok László & Sulyokné Kökény Tünde
Dr. Surányi Katalin & Gazdig Sándor
Dr. Szénai László & Dr. Szénainé Kovács Gabriella
Szöllösi Cecília
Tanács Erika
Tanács Ferenc & Tanács Ferencé
Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Varga Józsefné
Visnovszky Ramóna & Bognár Gábor
Jozefa Zore

Zsidai Renáta

NIVELI 2

Haim Józsefné & Haim József
Kása István & Kása Istvánné
Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes
Orosházi Diána
Siklósné Dr. Révész Edit & Siklós Zoltán
Tihomir Stilin & Maja Stilin
Utasi István & Utasi Anita

NIVELI 3

Berkics Miklós
Tomislav Brumec & Andreja Brumec
Budai Tamás & Budai-Schwarcz Éva
Fekete Zsolt & Ruskó Noémi
Halmi István & Halminé Mikola Rita
Herman Terézia
Krizsó Ágnes
Leveleki Zsolt & Leveleki Anita
Stevan Lomjanski & Veronika Lomjanski
Szabó József & Szabó Józsefné
Tóth Sándor & Vanya Edina
Vágási Aranka & Kovács András
Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea

CONQUISTADOR CLUB

07. 2012. DHJETË DISTRIBUTORËT MË TË SUKSESSHËM NË BAZË TË PIKËVE PERSONALE DHE TË NON-MENAXHERIT



HUNGARIA



1. Nagy Andrea
2. Erika Davis & Henry Davis
3. Halmi István & Halminé Mikola Rita
4. Dr. Keresztényi Albert
5. Meggyesi Imre & Meggyesiné Kántor Tamara
6. Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
7. Mázás József
8. Csuka György & Dr. Bagoly Ibolya
9. Halmi Bence István
10. Tóth Tamás & Bostyai Emília



KROACIA



1. Jadranka Kraljić-Pavletić & Nenad Pavletić
2. Matija Jagodin & Sandra Jagodin



SLLOVENIA



1. Ana Cvijanović & Božidar Cvijanović



SERBIA



1. Predrag Živković & Svetlana Živković



TË DASHUR BASHKPUNËTORË RRJETNDËRTUES!

Me siguri ju kujtohet fushata jonë në shkallë të gjërë në muajin Prill, e nxitur me kërkesën e qëndrës në Amerikë, fushatë e cila që nga ajo kohë ka vazhduar me sukses, dhe qëllimi i të cilës ka qënë riaktivizimi i bashkpunëtorëve që nuk kanë blerë prej shumë kohësh.


Kemi kërkuar ata distributorë të regjistruar, që për herë të fundit kanë blerë para dhjetorit të 2010. Ata që kanë adresë E-mail, atëhere me E-mail, ata që kanë telefon me telefon, ndërsa të tjerët të mund ti kontaktojmë me një njoftim të dërguar me postë me „kartonin jeshil”. Të interesuarve, me kërkesën e tyre u dërguam falas katalogun 3 dimensional të produkteve, që mund të marrin informacion edhe për produktet e reja.

Si rezultat e i kësaj fushate deri tani janë kthyer tek ne 2-3 mijë bashkpunëtorë dhe konsumojnë përsëri produktet e shkëlqyera të FLP. Që nga ajo kohë njëri në 5 vetë është bërë blerës i rregullt.

Objektivi ynë është që në 2012 të bëjmë të interesuar për këtë biznes rreth 4 mijë distributorë që nuk kanë qënë aktiv.

Meqënëse si mjeti më efektiv ka rezultuar telefoni, edhe në të ardhmen tek ky do ta vëmë theksin. Gjatë kontakteve kemi freskuar edhe bazën e të dhënave, në çdo rast bëhet krahasimi i të dhënave dhe kështu për bashkpunëtorët që riaktivizohen mund tju sigurojmë edhe juve një informacion më të freskët.

Të mendojmë dhe të veprojmë së bashku! Presim përvojën, idetë dhe propozimet tuaja lidhur me këtë fushatë.



Ndarja e distributorëve të rikthyer, si janë kërkuar (statistika hungareze)



**INFORMOHU PËR AKSIONET, RISITË DHE IDETË TONA NGA DORA E PARË!
LIDHU ME KOMUNITETIN E FLP EDHE NË FACEBOOK!**

Forever Living Products (Hungary) Ltd

<http://www.facebook.com/pages/FOREVER-LIVING-PRODUCTS-ALBANIA/177450245638111>

WWW.FOREVERUTAZAS.HU

Regjistrimi në
programin e udhëtimit
është falas deri
31.12.2012



Në sistemin e udhëtimit me skonto Forever Utazás
mund të futesh në këtë mënyrë

1. Futu në faqen www.foreverutazas.hu !
2. Kliko për regjistrim dhe shkruaj të dhënat e tua në emër të personit ose firmës të regjistruar në FLP!
3. Në mënyrën e pagesës zgjidh optionin regjistrim falas deri 31.12.2012
4. Jep passwordin që ruan të dhënat e tua!
5. Për regjistrimin e sukseshëm informohesh në adresën tënde të E-mailit.

Forever Utazási Információs Pont

1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11.

Személyes ügyintézés: + 36 70/777 9997



Këshilla për shëndetin me fillimin e shkollës

Dalë nga dalë i erdhi fundi verës, dhe erdhi përsëri fillimi shkollës. Secili sipas kërkesave të moshës fillon vitin e ri mësimor. Me disa nga këshillat e mëposhtme do të donim të kontribuonim për fillimin e shkollës me sa më pak shqetësime dhe për arritjen e një rezultati sa më të mirë.

1. Fillimi i shkollës fsheh në vetvete shumë emocione dhe tension. Ndesh me një mjedis të ri, me njerëz të rinj, me mësues të rinj me tensionin në rezultateve apo me kujtesa të papëlqyeshme të të shkuarës. Ka rëndësi që si prindër ti ndihmojmë fëmijët tanë dhe të theksojmë pozitivitetin. Po kështu përgatitja shpirtërore mund të jetë po aq e rëndësishme sa edhe sigurimi i mjeteve mësimore. Kështu si zgjidhës i ankthit në raste të tilla mund të ndihmojë shumë qumështi i bletës. Ka rëndësi që të flasim hapur dhe shumë për frikën që ekziston, si një gjëndje e natyrshme dhe të mos i mësojmë fëmijët tanë që në rast ankthi tu drejtohem i ilaçeve. Një shetitje në natyrë dhe pak sport janë largues të shkëlqyer të stresit.

2. Pë shkak të detyrave të shkollës shpesh kemi dhimbjen e barkut në mëngjes. Në raste të tilla 1-2 lugë gjelle lëng Aloe do të bënte çudira për shkak të lëndëve qetsuese të dhimbjeve dhe paksuese të inflamacioneve.

3. Të kujdesemi me vetëdije që fëmijët tanë ta fillojnë shkollën duke patur një shëndet të plotë trupor. Për parandalimin e infeksioneve publike të luftojmë që sistemi i imunitetit të funksionojë në mënyrë optimale. Aloe Vera është bima medicinale që ushqen, gjallëron dhe i sjell harmoni organizmit. Qindra studime vërtetojnë se një florë e shëndetshme e zorrëve është arma mbrojtëse për parandalimin e infeksioneve. Është me interes të zgjedhim probiotik të tillë që përmban sa më shumë „bacile miqësor”. Bioflavonoidet me origjinë bimore apo ekstratet të Echinacea Angustifolia mund të luajnë rol të rëndësishëm gjatë kohës të forcimit të sistemit të imunitetit. Ta mbajmë në shtëpi propolisin që të luftojmë kundër bacileve. Vitamina C, zinku, vitamina D, këpurdhat maitake dhe shitake kanë efekte pozitive të sigurta me nivelin e frukto-oligosaharideve që ushqejnë florën e zorrëve.

4. Gjumi i mjaftueshëm është një nga kushtet kryesore për rezultate të mira. Duhet njohur fakti që duhet shtrirë për gjumë para mesnatës. Sigurisht para detyrave që duhen përgatitur për të nesërmen është e vështirë të fleg. Në raste të tilla një gotë qumësht me mjaltë, një tabletë me minerale, yndyrnat omega-3 dhe omega-9, vitamina B apo ploeni i bletës bëjnë çudira.

5. Për arritjen e rezultateve vazhdimisht të larta duhet të mendojmë që ta ushqejmë trurin që të funksionojë në mënyrë optimale. Ushqyerja sistematike mund ti sigurojë nivelin normal të sheqerit në gjak. Ka shumë rëndësi që në jetën e studentit të mos mungojë ngrënja e mëngjezit dhe ngrënja në pushimin e gjatë të mësimit. Vogëlshët shpesh lënë pa ngrënë mëngjezin vetëm që të flenë edhe një çerek ore më tepër. Në raste të tilla, një gotë lëng ushqyes pihet shpejt që si thonë „edhe mishi të piqet por edhe heli të mos digjet.” Ngrënja më kryesore e ditës është mëngjezi. Të ngulim këmbë që të mos e fillojmë ditën me stomakun bosh. Le ti japim në çantë edhe pak bukë me vete për ta ngrënë në pushimin e mësimt!


6. Shpesh për shkak të orarit të rreptë të orëve të mësimt, vogëlshët nuk guxojnë të pinë shumë lëngje sepse u vjen turp të kërkojnë leje para 25 nxënësve të dalin të bëjnë çifin. Por mungesa e lëngjeve shkakton mungesë vëmendje, kapsllëk dhe dhimbje koke. Prandaj ti paraprijmë këtij problemi. Le ti vendosim fëmijës në çantë pak ujë mineral jo i gazuar apo pak çaj aloe apo ndonjë lëng me origjinë bimore.

7. Për fat të keq, sot është e njohur publikisht që e pamundur të zgjidhësh ushqyerjen e kënaqshme për organizmin në këtë mënyrë jetese intensive. Ti paraprijmë mungesës të vitaminave dhe të lëndëve minerale, është logjike që ta ushqejmë organizmin me plotësues dietikë të cilësisë së lartë dhe me baza bimore. Unë si mjekë garantoj besimin tek produktet e Forever Living Products dhe me këto mbroj shëndetin e fëmijve të mij.

8. Të mbrojmë shtyllën kurrizore dhe kyçet e fëmijve tanë! Sipas rekomandimeve të të ortopedëve, pesha e çantës të shkollës nuk duhet të kalojë 10% të peshës trupore të fëmijës. Rëndësi ka edhe ecja e rregullt. Kjo është periudha e rritjes së shpejtë të njeriut. Të kujdesemi për prjen e vitaminave e të lëndëve minerale dhe të shmangim pirjen e lëngjeve të gazuara. Ti vëmë theks të vecantë kompensimit të duhur të vitaminës D! Me teste dermatologjike është vërtetuar bima medicinale e Aloes thithet shumë mirë përmes lëkurës. Është me interes që atë ta përdorim që lëndët e saj të efektshme të thithen sa më thellë nga trupi. Të mbrojmë në kohë kyçet e fëmijve që merren me sport, duke përdorur lëndë me përmbajtje sulfurit dhe forcues të kërcëve të kyçeve.

9. Vajza ime e klasës së katërt më tregoi se ka shokë klase që e kanë bërë zakon të blejnë me pare xhepi! Dhe madje sistematikisht. U habita shumë! Mendoj se fëmijët nuk duhet të pijnë pije energjije. Studentët e rritur më e shumta mund tu ofroj pije energjije me përmbajtje bimore që janë stimulant të sigurtë si guarana, ginseng dhe bimë të tjera. Në vend të kafes mund të pije freskuese me përmbajtje të ginsengut, apo Chia e artë. Ndërsa kërkon të freskosh pak trurin atëhere përdor ginko biloba që ka efekte të përmirësimit të kujtesës.

Dr. Francia Boglarka
Mjeko shtëpie, teraupetiste familjeje
Menaxhere



LITERATURA

1. Earl Mindel: Vitamin biblia, Glória Kiadó, 1985
2. Uwe Gröber: Interakciók gyógyszerek, vitaminok és nyomelemek között, Zafir Press, 2010
3. Dr. Peter Atherton: Aloe vera a gyógyító növény, Duna International, Bp., 2006
4. Csupor Dezső: Fitoterápia - növényi szerek a gyógyászatban, JATEPress, Szeged, 2009
5. Szendrei Kálmán és Csupor Dezső: Gyógynövénytár, Medicina Könyvkiadó, Bp., 2009
6. Dr. Dean Ornish: Spektrum, HVG Kiadó, Bp., 2010
7. Szendi Gábor: Paleolit táplálkozás, Jaffa Kiadó, Bp., 2009
10. B. Luban-Plozza: pszichoszomatikus betegek az orvosi gyakorlatban, Animula, Bp., 1994
11. Az iskolatáska súlya és a gyermekek gerincének egészsége (A Magyar Orvosi Kamara állásfoglalás), Bp., 2004. dec. 3.



SUCCO NEXT

LIRIA E ZGJEDHJES NË FLP

Para jetës time në FLP besoja se e dija çfarë ishte liria. E ndjeja veten të lirë, por duke hyrë në Forever dhe kur u bëra menaxher, u kuptova se nuk kisha qënë vërtet i lirë. kisha bërë jetën e një sklavi. Pra çështja shtrohet çfarë është liria? Sipas fjalorit kuptimin ia dimë të gjithë, në parim të gjithë jemi të lirë. Çështja shtrohet: a jemi vërtet të lirë. Personalisht mendoj se jo. Njeriu është i lumtur në qoftë se ka punë, marr një pagë dhe paguan këstet e kredisë. Punon gjithë ditën, të shtunë e të diel, disa herë edhe me orë të zgjatura. Vallë një njeri i tillë është njeri i lirë?

Një njeriu tjetër i duhet të punojë, ashtu dhe kurd o tjetri, pra duhet të punojë për aq para sa i ka caktuar tjetri. Vallë kjo është liria e vërtetë? A duam të jetojmë në një mënyrë të tillë? Çdo ditë takohemi me njerëz të tillë, që punojnë pikërisht kështu, për pak para, sepse kanë nënshkruar që për kaq do të punojnë. Shumë flasim për punëdhënësin tonë, për atë sa na vlerëson, , në qoftë se puna jonë kaq i vlen atij. Jetojmë në shtëpi dhe banesa të tilla që rënkojnë nga këstet e kredive. Drejtojmë makina që na i kanë dhënë me kredi firmat kredituese. Vallë kjo është liria e vërtetë? Po në qoftë se nuk arrijmë të shlyejmë kreditë, çfarë ndodh? Në çast mbetemi pa shtëpi e pa kredi. Kjo me siguri nuk është liri e vërtetë. Liri është ajo që kohëhën e lirë ta lalosh me familjen e me miqtë e tu, të udhëtosh, të merresh me gjëra të tilla, që të japin kënaqsi. Të jetë hobi yt. Por jo atëhere kur ta lejon dikush por atëhere kur e do ti.

Por në qoftë se ato që rreshtuam më lart nuk do të thonë liri, atëhere pse shumica e njerzve jeton kështu? Ndoshta pse nuk e dinë të mirën. Sepse që në rini ashtu janë mësuar: kjo ka qënë mënyra e vetme e drejtë e të jetuarit. Por ne në FLP e dimë, se nuk është kështu. Në Forever Living Products ka njerëz të tillë që kanë vendosur: të jetojnë të lirë. Punojnë kur duan, atje dhe me atë që duan. jetojnë me të ardhura të tilla që do ti dëshironim, jetojnë në shtëpitë e tyre, kanë veturat e tyre, venë me leje atje dhe atëhere kur duan. Menaxherët e FLP e dinë zgjedhjen. Ata kanë vendosur të marrin fatin e tyre në duart e veta, përcaktojnë vetë të ardhmen e vet dhe të familjeve të tyre.

Në qoftë se ti je arkitekt i të ardhmes tënde, atëhere i parashikon gjërat. Kjo është mënyra e vetme që të jetosh i lirë. Menaxherët e FLP e kanë kuptuar, që jeta të jep një shans më të ri, atë që e quajmë të nesërme. E kanë kuptuar se e vetmja gjë që mund të fajësojnë, është ajo që nuk e



CESS

EXIT →

kanë pranuar riskun e mundësisë që u është ofruar atyre. Në biznesin e FLP nuk ka risk, por një herë atij i duhet ti reagosh. Në fillim të gjithë ne kemi frikë. Trembemi dhe pyesim veten: si mund ta çoj deri në fund? Por kemi sponsorat tanë që na ndihmojnë. Duhet ta shmangim frikën e fillimit, duhet të reagojmë me guxim. Çdo menaxher i FLP një herë është përballur me rrezikun, mori guximin dhe u bë i vendosur me qëllim të arritjes të objektivit të tij, që të bëhet menaxher. Në qoftë se do të jesh më i pasur dhe më i lumtur, atëhere mësohu që të mendosh gjëra të mëdha.


Mos i vur kufij vetes, sepse çdo gjë që ekziston në rruzullin tokësor, është për ty. Mendo gjëra të mëdha, ashtu si inuk e bëjnë shumica e njerzve. Dhe atëhere do ta kuptosh se ndryshon nga shumica e njerzve të tjerë, dhe se jen ë rrugë të drejtë. Në fjalorin tënd duhet të mungojë fjala „e pamundur”. E pamundura është pikërisht justifikimi i njeriut të papërgatitur. E atyre që nuk janë të guximshëm, dhe të paafët të rrezikojnë. Kur realizon planin „e pamundura” bëhet e „mundur”. Për këtë ka nevojë të kemi besim në vetvete. Në qoftë se nuk keni besim tek vetja, atëhere edhe ne sponsorit tuaj më kot kemi besim tek ju. Duhet besim, besim tek FLP dhe tek produktet e saj. Në qoftë se e gjithë kjo ekziston, atëhere vërtet do të jetosh i lirë.

Një njeri i madh – Rex Maughan – preku ëndërrat e të gjithë neve, ndërsa neve na duhet të kërkojmë të tjerët. Të punojmë mirë me të tjerët, ky është parimi ynë udhëheqës. Nuk kemi ndryshim nga njerzit e tjerë. Por i ndryshëm është besimi dhe vizioni ynë, që e bën të mundur për çdo njeri, që të jetojë një jetë të lirë. Synimi i Rex është që çdo njeriu ti sigurojë jetën që meriton. Përhapja e idesë të tij çdo ditë – kjo është puna jonë, dhe kjo na siguron lirinë e plotë.

Edvard Badurina
menaxher - - Rijeka



FITORE ME FOREVERIN



Në lojrat olimpike të Londrës, skuadra hungareze e xhudos siguroi 13 pikë, 1 medalje argjendi, 1 medalje bronxi dhe 2 vende të 5-ta. Me këtë rezultat skuadra hungareze kontribuoi që në tabelën e pikëve të konkurimit të kombeve të zinte përkatësisht vendin e 9-të dhe të 14-të për medalje dhe për pikë.

Éva Csernoviczki me medalje bronzi dhe Miklós Ungvári me medalje argjenti i dhanë ekipit hungarez jehonën kryesore: në këtë olimpiadë ne mund të realizojmë vetëm mirë.

Ajo që na bëri më krenarë, ishte që të tetë pjestarët e ekipit të xhudos bashkë me trainerët dhe me federatën e tyre i përkasin familjes së madhe të Forever Hungari; të gjithë krenaria e skuadrës time të vogël.

Kjo filloi në verën e 2009, kur miku im i vjetër xhaxhi Feri Moravec, kapiteni i ekipit të sukseshëm të 1992 (Anti „Atom” Kovács, në atë kohë siguroi vëndin e parë në sportin e xhudos

të Hungarisë, dhe deri më sot është e vetmja medalje olimpike e artë), më kërkoi të provoj të mund të ndihmoj diçka, sepse kjo degë sporti kishte shumë nevojë për suksese.

U njoha me drejtuesit e kësaj dege, që besuan jo vetëm te fjalët, por natyrisht në argumentim ndihmoi shumë oferta „e plakut” të fortë, Xhaxhi Feri.

U njoha me babain e Éva Csernoviczki, kapitenen e ekipit. Asaj i interesonte gjithshka që mund të kontribuonte për arritjen e një rezultati sa më të mirë, parandalimin e dëmtimeve, si dhe që mund të ndihmonte për rigjenerimin

Biseduam bashkë për avantazhet e produkteve, mbas kësaj



pjestarët e ekipit filluan të përdorin produktet. Ndërsa suksesi i kampionatit europian në 2010 në Vjenë hodhi poshtë çdo dyshim; në garat e brezave në Hungari ekipi doli në vend të parë me 3 medalje të arta, 2 argjenti dhe 3 bronxi.

Edhe trenerët në atë kohë filluan të njihen me produktet dhe mësuan se lëngjet Freedom, dhe Freedom2Go, tabletat Active HA, Nature Min, Calcium, Bee Propolis, Bee Pollen, qumështi bletës Royal Jelly, dhe Fields of Greens mund të ndihmojnë sportistët, pa folur për efektin e kremrave dhe të sprajtit Aloe First.

Masazhieri i ekipit të Tatabányas dhe i kombtares zbuluan efektet pozitive të përzierjes të kremërave, pastaj erdhi ARG1+ të cilin e përzien me pluhurat Lite. Stërvitjen e ndihmuan edhe pija energjike FAB dhe çokollata Fast Break.

Të gjithë pinin vazhdimisht Freedom2Go, por edhe ARG1+, pluhuri Lite, pija FAB, Fast Break, tabletat e Calciumit, e Nature Min ishin pjesë e dietave, pa harruar kremërat si kremi ngrohës Heat Lotion, xheli MSM dhe kremërat e masazhit që përdoreshin rregullisht.

Sigurisht e gjithë kjo do të ishte pak, në qoftë se konkuresit nuk do të bënin në mënyrë sistematike punën stërvitore.

Janë faktorë të rëndësishëm si përgatitja fizike ashtu edhe ajo psikologjike.

Për në fund kam lënë një konkurent „të madh“, i cili për mua, megjithëse zuri vendin e 5-të, meritoi respektin më të lartë, dhe e shikoj si një kampion olimpik, ai është Abigél Joó. Suksesin e plotë ia pengoi një dëmtim serioz. Ai u dëmtua në ndeshjen me konkurrentin amerikan, që më vonë u bë kampion. Abigél udhëhiqte me avantazh serioz, por iu dëmtua një kërc i gjurit. Kundërshtari i njohur e dinte se goditja tek këmba e dëmtuar do ti sillte fitoren, dhe fatkeqsisht kështu ndodhi. Abigel duke

u ngritur nga kjo situatë gjatë ndeshjeve për në finale hodhi në tuç kundërshtarin polak, me këtë iu dha mundësia për të luftuar për medalje. Dëmtimi e pengoi të sigurote medaljen. Kundërshtari duke e sulmuar pothuajse vazhdimisht në këmbën e dëmtuar fitoi ndeshjen, kështu fitoi medaljen e bronxit, ndërsa Abigél zuri vendin e 5-të.

Abigél, me gjithë moshën 22 vjeçare, tashmë është 2 herë Kampion Europe, dhe prapë nuk heq dorë nga ëndërrat. Ka kaluar operacionin dhe tash përgatitet për kampionatin europian të të rinjve që do të zhvillohet në nëntor. As gjatë periudhës të rimëkëmbjes nuk ka hequr dorë nga produktet tona.

Për mua, produktet dhe puna do të thonë sukses, më tepër se kaq s'mund të thonë fjalët e kryetarit të Federatës, i cili në darkën e përcjelljes, megjithëse rezultatet nuk direshin, nga unë u nda duke thënë: „nga shtatori së bashku do të përgatitemi për në Rio“.

Në verën e 2011 ishin ttë ftuar nga unë në një bisedë për caktimin e objektivave Éva Csernoviczki, Miklós Ungvári dhe Csaba Csernoviczki. Me këta sportistë përgatitem nga një zarf, i mbyllëm dhe i vulosëm, dhe deri më sot Mihály Szép dhe Éva Keszi Szépné – soaring menaxherë presin që në kuadrin e një takimi të ri të shikojmë përmbajtjet e zarfave. Dy fituesit e medaljeve të lojrave olimpike do të na thonë si i kanë realizuar ëndërrat dhe objektivat e tyre.

Sepse nga kjo vetëm mund të mësojmë.

László Rosta
assistant manager





PA OBJEKTIVA

nuk mund të arrish qëllimin

TIBOR ÉLIÁS SOARING MENAXHER

KËNGËTAR OPERE, GAZETAR, REDAKTOR PËR ANËN KULTURORE NË TELEVISIONIN E QYTETIT DEBRECEN, KUJDESTAR FLUTURIMI NË MALEV, THEMELUESI I PARË I „SUPERMARKETIT ME PRODHIME HUNGAREZE“, PRONARI I KAFENESË SË DIKURSHME NOSZTALGIA TË SENTENDREIT, DREJTUES RESTORANTI NË HOTEL LLUKSOZ... ËSHTË E PABESUESHME, KY KA QËNË TIBOR ÉLIÁS. NDËRSA TANI, NUK ËSHTË VEÇSE NDËRTUES RRJETI NË FOREVER. DHE NUK FILLOI PËR PARA

Sponsor: Dr. Mária Pavkovic

Rjeti i sipërm: Illona Illyés, Zsófia Gergely, Aranka Vágási dhe András Kovács, Miklós Berkics, József Szabó, Rex Maughan

Nuk ishe i lumtur, si këngëtar i njohur opere?

Po isha shumë i lumtur. Sepse kam shëtitur gjithë botën. Kam interpretuar në skena të mëdha, gjatë 130 vjetëve vetëm unë e kam kënduar në Hungari në versionin original operën Peshkatarët e perlave të Bizës, - isha i suksesshëm... vetëm që në 1998 pata një problem me zemrën, që më urdhëroi të frenohesha. Flija nga dymbëdhjetë orë, por ngrihesha më i lodhur, se sa kur shtrihesha. Isha një njeri që luftoja me sëmundje si mbipesha dhe nervozizmi. Atëhere më gjeti **dr. Mária Pavkovic**. Atëhere as që e dinja, kush ishte ajo aloe vera, por isha kurioz, kush mund të jetë ajo zonjë me këtë emër të bukur, desha të takohesha me të. Më pas duke e njohur dhe e përdorur xhelin, u bëra gjithnjë e më i zjarrtë. U binda për efektet pozitive dhe se si mund të jetohej pa të, është vetëm çështje kohe. Provova ndryshimet pozitive, dhe me këtë desha të ndihmoja të gjithë. Sot konsumoj praktikisht të gjitha produktet, prandaj edhe di të punoj kaq shumë, të bëj jetë nate dhe të arrij rezultate. Të gjithëve u jepja produkte, prandaj pata edhe aq shumë pikë që në muajt e parë; brënda gjashtë muajve u bëra menaxher. Më pas më inspiruan sfidat, dhe kështu drejtuesit erdhën njëri pas tjetrit, bile në këtë vit dua të bëhem safir, për të cilën po punoj me shumë vetëdije.

Kaq thjeshtë?

Sigurisht. „Shumë më thonë: „po unë nuk jam i atillë”, d.m.th. si ndërtues rrjeti. Pse unë i atillë isha? Unë ashtu linda? Jo, por u bëra „i atillë”, sepse desha të mbledh informacione korrekte dhe të ndihmoj të dashurit e mi, miqtë dhe veten. Është e mrekullueshme, kur dhjetra mijë vetë të ngritur në këmbë të duartrokasin pas ngjites në skenë, por nuk ka ndjenjë më të mirë se ajo, kur dite ti ndihmosh dikujt si në problemin material ashtu edhe në stilin e jetesës.

Cili ishte ai moment, nën efektin e të cilit „ja përkushtove veten,, qind për qind ndërtimit të rrjetit?

Thyerja e një tubacioni kryesor; për shkak të tij kafeneja qëndroi e mbyllur për gjysëm viti, si përfundim mu desh ta shisnja. Por kurrë nuk u bëra ndërtues rrjeti për të mbijetuar, sepse kisha mundësi jetese edhe nga shumë gjëra të tjera, qoftë si këngëtar, si gazetar apo me turizëm. Vetëm se mua më pëlqeu ky profesion, dhe më pëlqen, kur shikoj zhvillim tek njerëzit. Ndhimoj të ndërtojnë rrjetin njerëz të tillë, të cilët ndoshta nuk kanë mundësi tjetër në duart e tyre. Para katërbëdhjetë vjetësh hyri në grupin tim një zonjë, **Iréнке Kassay**, tashmë në moshë të madhe dhe si përfundim pas trembëdhjetë vjetësh u bë menaxhere. Sot për atë jam më krenari, sepse krahas nipërve, mbesave dhe punëve të tjera pati zell, vendosmëri dhe ja arriti qëllimit. Apo aty është ai djali që ka difekt në të folur, i cili më pyeste: Tibor,





unë mund ta bëj këtë? Nëse do, atëhere po - i thashë. Po të kopjosh, çfarë funksionon, atëhere po. Por gjatë atyre muajve, mos planifiko asgjë tjetër, fokusohu! Dhe në muajin në vazhdim pati 32 pikë, ndërsa më parë Imi Bara mezi pati disa pikë. Por sot, edhe ai është shembull për shumë të tjerë, ashtu si edhe Irénke Kilián me grupin, apo Glóriá Geszty, dr. Edit Wohlmuth, Erika Hleba, Zoli Pallai, Kriszti Ilovai, Laci Blahunka, Toró me grupin si dhe të tjerët! Sepse sukcesi të deh, të çon drejt rezultateve, nëse shikon, që diçka funksionon, atëhere vendos brenda saj më shumë energji. Por e keqja është, që njerëzit më parë duan rezultat, se sa të punojnë për të, por kjo nuk funksionon kështu. Edhe në pajisjet e kafes më parë vendos paratë... me këtë dua të them, që këtë nuk mund ta prishësh, nuk mund ta bësh, - e shumta mund të mbetesh jashtë saj.

Çfarë ndodhi ndërkohë me funksionet e tjera?

Ato i lashë. Sepse me çfardo gjëje që merresha, gjithmonë desha më të mirën. Qoftë, si drejtues kryesor në turizëm – ku me grupin tim fituam nëpër gara – qoftë si këngëtar i 9 disqeve-cd. Hapa pasticerin Dobos dhe muzeumin e historikut të kafes, shkruajta libra... asgjë nuk vlen ti bësh vetëm për ti bërë, sepse atëhere edhe rezultati do të jetë i atillë! (nuk do të kesh). Jeta është e shkurtër, duhet të krijojmë atë që mbetet, të tillë, që të të lërë gjurmë dhe të jetojë përgjithmonë. Që është „forever”! Për këtë mundësi më të mirë se FLP-ja nuk gjeta. Në skenë kam luajtur role, por tani për herë të parë luaj rolin kryesor të jetës time. Tani nuk jam unë i rëndësishëm, por grupi, me të cilin luajm bashkë... dhe kjo skena këtu është e imja, është e jona! Ndërtojmë së bashku, për veten tonë, një jetë më të lumtur! Kush vjen, kush nuk vjen – unë shkoj më tej!

Çfarë duhet për ndërtim rrjeti të suksesshëm?

MLM sot nuk është tashmë si ajo para pesëmbëdhjet vjetësh. Këtu nuk bëjmë tregëti, nuk shfrytëzojmë rastet, nuk përdorim „dredhi”, nuk ndjekim suksesin e pamerituar. Këtu shikon të mbeten për një periudhë të gjatë vetëm ata njerëz, që punojnë pastër, me sinqeritet dhe ndershmëri. Dhe nga ky moment çdo gjë varet nga informacionet e mira apo të këqija që jep e merr. Sponzori im „Maria ime”, u djersit shumë deri sa më bëri të pranoj, që qëllimi është ndërtimi i rrjetit. Por besoj,

që ja vlejti përkushtimi i kohës dhe i energjisë me mua. Tani unë e transmetoj më tej stafetën duke e shtuar me përvojat personale! Tashmë prej shumë kohësh punoj vetëm, por gjërat e rëndësishme i diskutoj gjithmonë me Marian. Prandaj është i rëndësishëm sponzori, i cili e shikon nga jashtë jetën tënde, punën tënde, dhe nëse do ta ndjekësh atë, do kesh rezultat. Qëllimi është, që n.q.s. është e mundur, të bëhesh më i mirë edhe se ai! Dhe beso, që është e mundur!

Ti çfarë sponzori je?

Kryesorja është që, jam në brendësi të saj: e di, se çfarë është ajo, që funksionon në këtë detyrë, por çështja qëndron, se sa di ta transmetoj, dhe sa „blerës” është partneri i ardhshëm. Sepse gabimisht e di unë, nëse tjetri nuk beson në vetvete, që është i aftë ta bëjë, atëhere nuk kemi arritur asgjë. Sa njerëz me zell kanë ardhur nëpër seminare dhe janë larguar të pa qartë! Çdo gjë mund të mësohet, n.q.s. dëshiron. Dhe atë që mëson falas këtu në Forever, mund ta përdorësh mijra herë në çdo fushë të jetës!

Ata ku e kanë prishur?

